

Mbahet tryezë diskutimi për gjithëpërfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuara në studime dhe në shkëmbime studentore

Profesori nga Lituania Tomas Tamulevičius mban ligjëratë me studentët e Fakultetit Ekonomik

Viktorija Čeplikë nga SMK College i Lituanisë mban ligjëratë për studentët e Fakultetit të Arteve

Prorektorja Venera Lljunji mban sesion prezantues për Kolegjin AAB në Javën Ndërkombëtare të Stafit

Profesori nga Kroacia Dejan Gluvačević mban punëtori dhe ligjëratë me studentët e Kolegjit AAB

Zyra për Zhvillimin e Projekteve mban punëtori me pjesëmarrësit në Javën Ndërkombëtare të Stafit në Kolegjin AAB

Profesoresha nga Universiteti Koç – Turqi, mban ligjëratë në Kolegjin AAB në Javën Ndërkombëtare të Stafit



Hapet zyrtarisht Java Ndërkombëtare e Stafit në KOLEGJIN AAB

Kjo organizim i rëndësishëm shërben për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, ofron mundësi për zhvillim dhe trajnim profesional, promovon mirëkuptimin dhe shkëmbimin ndërkulturor duke përfshirur kulturën, traditën dhe vlerat e Kosovës, si dhe përfshirjen në dialog dhe diskutime rreth perspektivave të ndryshme kulturore.

Në vazhden e aktiviteve të Javës Ndërkombëtare të Stafit në Kolegjin AAB, prorektorja Venera Lljunji foli për strategjinë dhe planin zhvillues të institucionit për gjithëpërfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të marginalizuara, në studime dhe shkëmbime studentore.

Drejtoresha e Zyrës për Zhvillim të Projekteve Ilirjana Geci, prezantoi projektin e Kolegjit AAB në kuadër të thirrjeve me programin Erasmus+, përkritazi me temën e tryezës.

Të ftuarit treguan situatat në universitetet e tyre dhe folën për qasjen të cilën mbajnë lidhur me këtë çështje të ndryshme, duke sjellur përvoja nga vende të ndryshme në zhvillim të Bashkimit Evropian.

Për të diskutuar rreth "Business development", profesori Tomas Tamulevičius (ISM University of Management and Economics), ka mbajtur ligjëratë për studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB.

Në këtë ligjëratë profesori Tamulevičius u fokusua në mënyrat e zhvillimit të biznesit, duke iu treguar studentëve shembuj konkret shpeshherë edhe nga përvojat e tij personale.

Studentët gjithashtu u informuan për strategji të ndryshme që mund të përdorin për të zhvilluar bizneset, idetë apo synimet që kanë në fushën e ekonomisë.

Kjo ligjëratë u zhvillua në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit e organizuar nga Kolegji AAB.

Në Javën Ndërkombëtare të Stafit që po mbahet në Kolegjin AAB, kanë vazhduar ligjëratat nga profesorët e universiteteve ndërkombëtare.

Studentët e Fakultetit të Arteve, ishin pjesë e ligjëratës të zhvilluar nga profesoresha Viktorija Čeplikë, nga SMK College of Applied Sciences në Lituani.

Tema e ligjëratës ishte "Smooth production planning in Fashion", për të cilën Čeplikë ndau përvojat e saj si drejtuese e një kompanie prodhuese për 15 vite radhazi.

Ajo për studentët prezantoi "Smooth production plan", duke iu treguar në detaje rreth asaj që duhet të bëjnë si dizajnerë të modës në të ardhmen.

Studentët patën disa pyetje për profesoreshën nga Lituania, ndërsa ndoqën planin të cilin mund ta zbatojnë për profesionin e tyre.

Në ditën e dytë të Javës Ndërkombëtare të Stafit, prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim Venera Lljunji, përmes një sesioni prezantues ka informuar pjesëmarrësit për Kolegjin AAB.

Në këtë prezantim janë përfshirë programet e studimit që ofrohen, bashkëpunimet me universitete ndërkombëtare, rëndësinë e shkëmbimeve dhe bashkëpunimin në fushën e hulumtimit dhe botimit.

Pas prezantimit u mbajt tryezë diskutimi, ku u fol për ndërkombëtarizimin si mënyrë e avancimit të arsimit të lartë, si dhe arsyet përse partnerët aktual dhe institucionet e tjera ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë me Kolegjin AAB.

Të pranishmit u pajtuan që ndërkombëtarizimi ekspozon studentët dhe personelin akademik ndaj qasjeve të ndryshme, perspektivave, kulturave dhe mënyrave të ndryshme të menduarit.

Në kuadër të aktiviteve të shumta të Javës Ndërkombëtare të Stafit që po mbahen në Kolegjin AAB, profesori nga Bernays College, Dejan Gluvačević, ka mbajtur mban punëtori dhe ligjëratë për studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe të Fakultetit të Komunikimit Masiv.

Tema që solli profesori Gluvačević ishte "Country branding: Creating identity map of Kosovo for country brand purpose".

Studentët mësuan rreth koncepteve të brenndimit, imazhit dhe identitetit të një vendi. Ata zhvilluan diskutime të mirëfillta përmes aktiviteve të lidhura ngushtë me temën e trajtuar.

Drejtoresha e Zyrës për Projekte, Ilirjana Geci, dhe Zyrtarja për Projekte, Erëza Mehmeti, kanë mbajtur punëtori me pjesëmarrësit e Javës Ndërkombëtare të Stafit, për të shqyrtuar mundësitë konkrete të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit AAB dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar.

Ndër të tjera, përfaqësueset e zyrës prezantuan projektet aktuale në implementim dhe fushat e synuara në të ardhmen për të iniciuar dhe zbatuar intervenime të reja. Gjithashtu, u prezantua platforma "E-Projects", e zhvilluar për nevojat e projekteve në Kolegjin AAB, e cila ka mundësuar digjitalizimin e të gjitha proceseve të projekteve. Ekspertiza e Kolegjit AAB në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një platforme të tillë, u konsiderua shumë e vlefshme edhe për partnerët ndërkombëtar.

Punëtorja vijoi me diskutimet rreth çështjeve prioritare për bashkëpunim me profesorët ndërkombëtar, duke synuar shkëmbimin e ekspertizës për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe u finalizua me disa iniciativa konkrete, të cilat do të shërbejnë si një bazë për zhvillimin e projekteve të reja.

Sot në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, profesoresha nga Universiteti Koç Gülfer Göze në Turqi, ka mbajtur ligjëratë për studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Tema e ligjëratës ishte "Academic vs non-academic writing", ku u diskutua për gjuhën angleze në kontekstin social dhe kontekstin akademik.

Përveç ligjëratës, studentët patën edhe disa ushtrime në të cilat morën pjesë që ndërlidheshin me gjuhën akademike, ndërsa patën rastin të punojnë edhe si grup për të dhënë secili idetë dhe angazhimin e tyre.

